

**ENKELEJDA ALITE**

**NIPT L01606037A**

**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**

**Mob. +355 (0)67 2005022**

**e-mail:enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 09.09.2024**


**Lënda: Relacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023 për Partinë Lista e Barabartë**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit**

Ju lutem bashkangjitur do të gjeni informacionin për mosrealizimin e misionit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023 për Partinë Lista e Barabartë.

Me respekt,

**Auditues Ligjor  
Enkelejda Alite**



**ENKELEJDA ALITE**

**NIPT L01606037A**

**Adresa: Rr.Abdi Toptani,Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**

**Mob. +355 (0)67 2005022**

**e-mail:enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 05.09.2024**

**Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë viti kalendarik 2023 për Partinë Lista e Barabartë**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.65, datë 28.06.2024, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 11(njëmbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe Partia Lista e Barabartë.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 06.08.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë Lista e Barabartë për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me postë të letrave me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë vënë në dispozicion nga KQZ-ja.

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi ne morëm përgjigje në lidhje me këtë letër se **adresa e subjektit politik është e pamjaftueshme.**

Për këtë parti u përdorën gjithashtu dhe komunikimet që mundëm të merrnim nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, nga kerkime ne internet por dhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.


Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me këtë parti por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë Lista e Barabartë nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues: Letra e dërguar me postë dhe konfirmimi i shërbimit postar për dërgimin e kësaj letre me kthim përgjigje.


Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**Enkelejda Alite**

**Auditues Ligjor**



SHQIPTARE sh.a.  
tare



18  
E BARRA BARTE  
, Nr. 5

Ky lajmërim - marrje do të kthehet  
në adresën time si më poshtë:

het nga dërguesi  
het të tregojë drejtimin  
lotë për kthimin  
ajmërimi

*Awil Hilok*

Z. ENKEURJIAH AUTE  
S.RU Abou Topdani  
Tovre Aviu, kade C  
Zyra 18, Tirane


Mod. E-10

KTHEHET

I PANJOHUR	<input type="checkbox"/>
LARGUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PANJAFUESHME	<input checked="" type="checkbox"/>
KA NDRYSHUAR ADRESE	<input type="checkbox"/>
OBJEKTI PA KERKUAR	<input type="checkbox"/>
REFUZUAR	<input type="checkbox"/>
ADRESE E PASAKTE	<input type="checkbox"/>

DATA E KTHIMIT

*Sh  
Sh  
Po*



3

Nr: 1001

DEFTесе 06/08/2024 11:31:30

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

Objekti Letra Leter  
KOD-BAR RR646962443AA  
Derguesi ENKELEJDA ALITE  
Marresi PARTIA LISTA E BARABARTE

Vend Mberritja TIRANA  
Pesha 10 gr  
LM RR643125049AA

Sherbime te vecanta 50  
LM ne postim 50

Tarifa Shtese 50

Tarifa Postare 70

Tarifa Totale 120

Nenshkrimi: Marjola Odobashi

Tiranë, më 06.08.2024

**Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor**

**Për: Partia Lista e Barabartë**

**Adresa e selisë: Rr.Sami Frashëri, nr.5,Tiranë**

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.65, datë 28.06.2024 , jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Lista e Barabartë gjatë vitit kalendarik 2023, të deklaruar në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës nr.2245 prot. datë 29.07.2024, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre". Afati kufi i përfundimit të procesit të auditimit është data 29.08.2024.*

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,regjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

**Enkelejda Alite  
Auditues Ligjor**

